



# OpenEMIS

Better data. Better outcomes.



**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

**OpenEMIS Kosovë  
Raport mbi misionin e fushëveprimit  
Nëntor 2017**

## Përmbajta

<b>Përmbajta</b>	<b>2</b>
<b>Hyrje</b>	<b>3</b>
<b>Metodologjia</b>	<b>4</b>
<b>Përparësitë dhe boshllëqet e SMIA-s aktuale</b>	<b>4</b>
<b>Raportimi për FAK</b>	<b>6</b>
<b>Vështrime dhe rekomandime</b>	<b>7</b>
<b>Studim rasti i OpenEMIS në Jordani</b>	<b>8</b>

## Raport vlerësues i nevojave dhe boshllëqeve<sup>1</sup>

### Hyrje

Misioni i fushëveprimit, i cili përbëhet prej vlerësimit të nevojave dhe analizës së boshllëqeve, është realizuar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (“Ministria”) dhe në bashkëpunim me “Save the Children Kosovë” dhe “Save the Children Suedi”, nga data 6 deri më 10 nëntor në Prishtinë, Republika e Kosovës. Qëllimi fillestar i këtij aktiviteti ishte të vlerësojë mënyrat me të cilat OpenEMIS mund të adresojë dhe të drejtojë proceset aktuale; megjithatë për shkak të kredisë së Bankës Botërore, që e ka marrë së fundi MASHT për përmirësimin e Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA), raporti vijues do të përqendrohet në përshkrimin e boshllëqeve që duhen plotësuar me SMIA-në re.

Është e qartë se Ministria po punon drejt përmirësimit të sektorit të saj të arsimit dhe ajo është zotuar për arritjen e caqeve të përcaktuara në Planin e ri Strategjik. Ndryshimet që po implementohen dhe planet e mëtutjeshme do të ndihmojnë në implementimin e suksesshëm të një SMIA të re në Kosovë.

SMIA e re duhet të mbështesë Ministrinë përmes ndërtimit të një e Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim, i fortë dhe i besueshëm, dhe të fuqizojë kapacitetet vendore për menaxhim si dhe të sigurojë informata të besueshme për planifikim, monitorim dhe vlerësim të arsimit në Kosovë. Ky mjet duhet të jetë fleksibil dhe lehtësisht i ndryshueshëm ashtu siç mund të ndryshojë edhe sektori arsimor në Kosovë, pa ngarkesë të madhe financiare për Ministrinë.

Parimet themelore kryesore për implementim të çdo SMIA efektive janë:

- Një qasje e bazuar në dëshmi, e cila përdor të dhëna të besueshme për të informuar proceset për planifikim dhe vendimmarrje në arsim, përmes fuqizimit të sistemeve ekzistuese informative në vend;
- Lidhshmëri kombëtare me pjesëmarrje të plotë dhe angazhim të palëve të interesit vendore në përcaktimin, formulimin dhe implementimin e një plani;
- Rreshtimi i SMIA në kuadër të qëllimeve dhe objektivave të përgjithshme zhvillimore për arsim në vend;
- Mbështetja e qeverisë në zhvillimin e sistemeve informative efektive dhe të fuqishme dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave, përmes përdorimit të mjeteve të TI, të hapura, të përgjithshme dhe kosto-efektive;
- Përdorimi i standardeve ndërkombëtare për shkëmbimin e të dhënave për arsim në vend me qëllim të përmirësimit të qasjes në informata dhe të përdorimit të tyre;

---

<sup>1</sup> Ju lutem, vini re se ky raport është version i shkurtuar i raportit për Misionin e Fushëveprimit të OpenEMIS në Kosovë, i përgatitur për “Save the Children Suedi” dhe “Save the Children Kosovë”.

- SMIA e qeverisë, e integruar në një sistem të fortë arsimor, i mbështetur në vendime, me menaxhim të sistemit që transferohet tek institucionet qeveritare kryesore pa qenë i varur në mbështetjen e jashtme teknike.

## Metodologjia

Metodologjia e përgjithshme e aktivitetit fillestar ishte angazhimi të gjitha palëve të interesit kryesore në arsim për hartëzimin e proceseve dhe të nevojave, identifikimin e boshllëqeve në proceset e mbledhjes së të dhënave, me qëllim të mbështetjes së përmirësimit të planifikimit afatgjatë në sektorin arsimor. Misioni i fushëveprimit do të planifikojë një qasje për fuqizimin e mjeteve për mbledhjen e të dhënave dhe fuqizimin e sistemit informativ arsimor, me një fokus të veçantë tek fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ekipi ka mbuluar temat kryesore vijuese:

1. Gjendja aktuale e SMIA
2. Plani për zhvillimin e SMIA të re, bazuar në mirëkuptimin e secilës njësi
3. Proceset për mbledhjen e të dhënave dhe mjetet për secilën njësi
4. Përdorimi i të dhënave shitesë për plotësimin e boshllëqeve aktuale
5. Kërkesat për mjetet e raportimit
6. Kërkesat funksionale si dhe për të dhënat për SMIA-n e re.
7. Lidhshmëria dhe çështjet e teprisë së të dhënave me nën-sisteme dhe sisteme të jashtme

Gjatë kohës në vend, ekipi i OpenEMIS pati rastin të bisedojë me palë të interesit për arsim nga Divizioni i SMIA, me inspektorate, me ekipin gjithëpërfshirës për arsim, shkollën “Sylejman Vokshi”, drejtoratin për arsim, kuvendin e nxënësve, Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Divizionin e Statistikave si dhe objektet e infrastrukturës dhe të arsimit.

## Përparësitë dhe boshllëqet e SMIA-s aktuale

### Përparësitë e sistemit aktual

Ministria aktualisht menaxhon një sistem SMIA që mbledh të dhënat e nivelit të përgjithshëm nga të gjitha institucionet publike në Kosovë. Është e rëndësishme të theksohen përparësitë vijuese:

- Kapaciteti i Ministrisë në përdorimin e mjeteve të bazës së të dhënave dhe formateve digjitale për mbledhjen e të dhënave është mjaft i avancuar dhe do të jetë një faktor pozitiv në implementimin e mjetit të rishikuar.
- SMIA aktuale mbledh informata në emër të shkollës, adresa, infrastruktura fizike e shkollës, qasja në ujë të pijshëm dhe higjienë, energjia elektrike, pjesëmarrja e përgjithshme, incidentet e dhunës dhe një sistem i paralajmërimit të hershëm. Ai po ashtu mbledh informata për gjininë, racën, etninë e nxënësve, distancën deri në shkollë, statusin e tyre ekonomik dhe përbërjen e familjeve të tyre. Lidhur me personelin, informatat individuale mblidhen për datën e lindjes, pozitën, racën,

gjininë, lëndët që i mësojnë, kualifikimet dhe licencat. Ministria ka një mjet të veçantë që përcjell procesin e licencimit. Ai numër licence pastaj përdoret në sistemin SMIA për të përcjellë personelin.

- Drejtorati për arsim në nivel rajonal përdor të dhënat e mbledhura përmes sistemit SMIA për të informuar për projektet dhe proceset e tij. Shefi ka mundësi të nxjerrë informata nga sistemi dhe të përgatisë raporte që nevojiten për raportim dhe vlerësim të tyre.
- KAS luan një rol të rëndësishëm në paraqitjen e një pasqyre të plotë të arsimit në Kosovë, meqë ata janë njësia e vetme që mbledh të dhëna nga shkollat dhe universitetet serbe.
- Njësia e infrastrukturës ka bazën e tyre të të dhënave Access, të cilën e përdorin për të mbajtur informatat për strukturën dhe përbërjen e të gjitha institucioneve.
- Ekziston një ekip i fortë që është në dispozicion për të vazhduar më tej implementimin e një SMIA të re.
- Shkollat janë të pajisura mirë me pajisjet e nevojshme për të mbështetur OpenEMIS, përfshirë këtu lidhjen e internetit.
- Drejtorët e shkollave janë të pajisur mirë për të kryer aktivitete që kanë të bëjnë me SMIA-n.
- Si rezultat i suksesit të sistemit aktual SMIA dhe protokolleve, MASHT në Kosovë është në pozitë të mirë për të marrë përsipër mbledhjen e të dhënave për nxënës dhe personel individual.

### **Sfidat në sistemin aktual**

Përdorimi i sistemit aktual është inkurajues, për arsyt e sipërpërmendura; megjithatë, ka kufizime në sistem që duhen marrë parasysh. Midis tjerash:

- Aktualisht, për të dhënat e fundit në arsim në nivel të përgjithshëm është në dispozicion qasja digjitale; megjithatë nuk ka qasje në të dhëna në nivel individual. Të dhënat janë në dispozicion në nivel të përgjithshëm në zyrën e SMIA dhe në njësitë e tjera (emri...) në kuadër të Ministrisë të cilat e kanë bazën e tyre të veçantë të të dhënave, mirëpo ku nuk ka sistem të fortë për menaxhimin e të dhënave në nivel të nxënies.
- Njësitë dhe ministritë e ndryshme kanë baza të ndryshme të dhënash dhe procese për mbledhjen e të dhënave.
- Ka pak komunikim midis njësive dhe ministrive sa i përket ndarjes së të dhënave.
- Sistemi aktual nuk ofron informata gjithëpërfshirëse përkatëse për Ministrinë sa i përket fushave prioritare, përfshirë por jo edhe kufizuar në, pjesëmarrjen dhe sjelljen individuale, gjendjen e shkrim-leximit, provimet, normat e përsëritjeve të klasave dhe braktisjeve të shkollave, librat shkollorë si dhe vlerësimet që përcaktohen në Planin e Sektorit të Arsimit.
- SMIA aktuale është përgatitur nga një kopani maqedonase në vitin 2011 dhe ata filluan ta përdorin atë në vitin 2013. Ky mjet është mjet pronësor i zhvilluar në mënyrë specifike për Kosovë. Jo të gjithë anëtarët e Ministrisë kanë qasje në këtë

mjet dhe marrëveshja për shërbime me kompaninë tani ka skaduar, dhe kështu qasja nuk mund të jepet më.

- Inspektoratet janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e shkollave sa i përket kurrikulave, infrastrukturës, mbledhjes së të dhënave, regjistrimeve, personelit dhe ofrimin e përgjithshëm të shërbimeve cilësore. Pas çdo vizite në terren inspektori arsimor përgatit një raport ku paraqitet gjendja faktike dhe ku propozohen masa për shmangien e dështimeve. Raportet e përgatitur nga inspektorati ndahen me të tjerët duke e bërë kështu të vështirë gjurmimin dhe përcjelljen e informatave.
- Shkollat kanë një proces të plotë për mbledhjen e të dhënave për institucionet e tyre, megjithatë këto të dhëna mbahen në disa libra të ndryshëm dhe procesi është mjaft i lodhshëm si për mësimmshënësit ashtu edhe për drejtorët.
- Kërkesat për vetëm të dhëna të plota japin pak stimulim për drejtorët që të mbledhin të dhëna në nivel individual.

## Raportimi për FAK

Plani strategjik për arsim i Kosovës përcakton arsimin gjithëpërfshirës si objektivën e tij të parë. Krijimi i një sistemi të integruar për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave, i cili do të mundësojë monitorimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, numrin e braktisjeve të shkollave dhe të paregjistruarve është qenësor për realizimin e kësaj objekte.

### Sfidat:

- Lidhur me Arsimin gjithëpërfshirës, e vetmja informatë e mbledhur përmes SMIA lidhur me këtë temë është numri i përgjithshëm i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara (FAK).
- Njësia e infrastrukturës nuk mbledh informata për FAK, edhe pse ata mbledhin informata nëse institucioni ka shkallë lëvizëse, toalete dhe klasa me mundësi qasjeje për ta. Para së gjithash, ata mbledhin informata nëse një ndërtesë ka qasje apo jo; megjithatë, nuk ishte e qartë nga bisedat se çfarë nënkuptonte se një ndërtesë kishte qasje.
- Sa i përket FAK, MASHT është përgjegjësi i vetëm për mbledhjen re të dhënave për FAK. Herën e fundit kur KAS ka bërë një anketim mbi këtë temë ishte viti 2011.
- Në mënyrë që kjo objektivë të përmbushet, është e domosdoshme që ekipi i Arsimin gjithëpërfshirës të luajë një rol të rëndësishëm në përgatitjen e TeR, të cilët do të përcaktojnë parametrat për sistemin e ri SMIA. Në kohën e misionit të fushëveprimit, nuk ishte e qartë se çfarë përfshihej në TeR dhe se si përfshiheshin kërkesat e kësaj njësie.
- Inspektorati nuk mbledh asnjë të dhënë për Arsimin gjithëpërfshirës e as nuk bëhen inspektime të veçanta për mundësinë e qasjes ose për shërbimet që ofrohen për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Për shkak të mungesës së informatave të duhura për FAK, ka instanca në të cilat aftësitë e kufizuara mbi-raportohen; për shembull, për shkak të përcaktimeve jo të duhura fëmijët me syze raportoheshin si persona me aftësi të kufizuara.

- Mungesa e diagnozës së aftësisë së kufizuar ose dëmtimit të fëmijës.
- Numri i përgjithshëm i FAK është i besueshëm vetëm për qendrat burimore, meqë ekipi i edukimit gjithëpërfshires mbikëqyr mbledhjen e të dhënave. Është e vështirë që të kemi një numër të përgjithshëm të FAK në mbarë Kosovën.
- Në shumë komuna, ata nuk kanë një numër të përgjithshëm të FAK që kërkon transport e as nuk kanë numër të përfituesve nga programet për transport.
- Atyre aktualisht u mungojnë informata për planin arsimor të FAK.

## Vështrime dhe rekomandime

Gjatë misionit në vend dhe takimeve të shumta me palët e interesit të Ministrisë, ekipi i OpenEMIS mund të japë vështrimet dhe rekomandimet vijuese.

### Vështrime

- Ministria e Punës aktualisht po përgatitë një bazë të dhënash për përfitues, e cila do t'u mundësojë atyre të mbledhin të dhënat e nevojshme për përmirësimin e projekteve të tyre dhe e cila bazë të dhënash është e lidhur në mënyrë të vazhdueshme nga niveli kombëtar në komuna, duke siguruar kështu një mekanizëm më të lehtë për mbledhjen e të dhënave dhe për raportim.
- Ministria po bën investime të mëdha për përmirësimin e sektorit arsimor; zyrtarët e Ministrisë janë zotuar për përmirësimin e të dhënave për arsim me shpresën për formulimin e politikave të bazuara në dëshmi.
- Ministria ka marrë një kredi nga Banka Botërore për rihvillimin e SMIA-s së tyre.

### Rekomandime

- Suksesi i sistemit të ri SMIA do të varet nga procesi dhe kapaciteti i Ministrisë për të *përcaktuar qartë kërkesat dhe nevojat e secilës njësi për mjetin e ri*. Proceset dhe nevojat për të dhëna duhet të jenë të fuqishme dhe të përcaktuara qartë dhe personeli duhet të ketë njohuri dhe aftësi për realizimin e detyrave të përcaktuara për ta në kuadër të këtyre mekanizmave.
- Me lëvizjen e MASHT-it drejt një formule të re financiare, burimet e alokuara për edukimin gjithëpërfshirës do të bazohen në numrin e shërbimeve për nevojat e FAK. Nëse numri i FAK nuk duhet dhe mbetet i marginalizuar, burimet e alokuara nga MASHT nuk do të jenë kurrë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e këtyre fëmijëve.
- **Meqë Ministria e Punës punon në zhvillimin e bazës së tyre të re të të dhënave, ajo inkurajohet që të krijojë një lidhje të qartë dhe një protokoll bashkëpunimi midis saj dhe MASHT.** Ministria e Punës do të jetë një pikë e mirë hyrës dhe identifikimi për FAK, meqë ka gjasa që familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara do të aplikojnë për mbështetje financiare. Shpesh ndodh që shumica e familjeve do të kërkojnë para për çështjet sociale, mirëpo ata nuk do t'i dërgojnë fëmijët në shkollë dhe duke i lidhur të dy bazat e të dhënave MASHT do të jetë në gjendje të identifikojë fëmijët që nuk e vijnë mësimin.

- Nëse MASHT kërkon të përcjellë performancën dhe përmirësimet, do të ishte e dobishme që sistemi SMIA të integrohet me provimet dhe që MASHT të mund të bëjë një analizë më të thellë për gjendjen e arsimit në Kosovë.
- Ekipi i Arsimit gjithëpërfshirës do të donte të mblidhte të dhëna për këto në vijim:
  - Emri dhe mbiemri
  - Niveli i arsimimit
  - Numri i përgjithshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuar
  - Lloji i aftësisë së kufizuar për fëmijë dhe shkalla
  - Shërbimet e ofruara nga shkolla
  - Shërbimet e ofruara nga komuna
  - Shërbimet e transportit dhe përfituesit
  - Kualifikimet e mësimeve, veçanërisht të atyre që kanë kualifikime për të mësuar FAK
  - Nxënësit që marrin plane për mësim individual
  - Të dhënat nga komunat për ekipet e vlerësimit dhe sa nxënës i vlerësojnë ato si dhe raportet
  - Të dhënat nga mësuesit e kohëpaskohshëm
  - Fëmijët jashtë shkollës
  - Normat e tranzicionit nga qendrat burimore tek shkollat e rregullta
  - Normat e braktisjes së shkollës dhe të atyre të mbajtjes
  - Trajnimi i mësimeve – mundësia për të identifikuar mësuesit që janë trajnuar në IE
  - Mundësia e qasjes në shkolla
- **Përfshirja e komuniteteve** në procesin e identifikimit të fëmijëve jashtë shkollës dhe të atyre FAK është dëshmuar e suksesshme në shumë kontekste. Gjatë takimit me Këshillin e fëmijëve në Mitrovicën e Jugut, ishte e qartë se organizatat e fëmijëve mund të luajnë një rol të rëndësishëm në Kosovë në identifikimin e FAK dhe në raportimin e çështjeve me të cilat përballen ata si dhe në identifikimin e faktorëve që i mbajnë fëmijët jashtë shkolle.
- **Zgjidhja teknologjike** - si shembull, një aplikacion mobil që mund të ofrojë platformë për fëmijët që të dërgojnë informata tek palët e interesit përkatëse lidhur me problemet e përfshirjes së FAK në shkolla të rregullta mund të përdoret nga fëmijët si burim i vlefshëm në procesin e reformave drejt gjithëpërfshirjes.

**SMIA që është pronë qeveritare, e integruar në një sistem të plotë arsimor të mbështetur nga vendimet, me menaxhimin e sistemit që transferohet te institucionet qeveritare kryesore, pa u varur në mbështetje të jashtme teknike.**

## Studim rasti i OpenEMIS në Jordani



Një shembull i implementimit të suksesshëm të SMIA në nivel kombëtar është përvoja e Jordanisë, ku teknologjia OpenEMIS përdoret nga Ministria e



Arsimit për të menaxhuar shënimet në mbarë vendin.

Ky sistem u lansua në gusht të vitit 2016, me mbështetjen financiare të BE-së dhe me asistencën teknike të UNESCO-s. Tani ai përdoret nga të gjitha 7,000 shkollat publike dhe private në atë vend, që nga kopshtet e fëmijëve deri në fund të shkollave të mesme, për të menaxhuar të dhënat e infrastrukturës, karrierat e personelit mësimdhënës dhe jomësimdhënës dhe për të përcjellë më shumë se dy milionë nxënës të regjistruar në shkolla.

Zgjidhja OpenEMIS në Jordani përbëhet prej një numri aplikacionesh të ndërlidhura, të bazuara në ueb që ofrojnë shërbime SMIA, të cilat shtrihen nga mbledhja e të dhënave deri tek menaxhimi i të dhënave, analiza e të dhënave dhe raportimi për shkolla, zyra qendrore dhe rajonale të Ministrisë së Arsimit.

Për më shumë informata lidhur me OpenEMIS në Jordani, ju lutem vizitoni:

- <https://www.youtube.com/watch?v=pHC4dgTcDkk> ose
- <https://news.OpenEMIS.org/2016/08/OpenEMIS-marks-a-new-era-of-education-planning-in-jordan/>
- <http://www.unesco.org/new/en/amman/projects/education/technical-assistance-to-enhance-accessibility-use-of-the-jordanian-moe-education-management-information-system-SMIA-for-evidence-based-policy-formulation/>